

VENDIM
Nr. 575, datë 3.10.2018

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 4 HA, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“FONSANA GRIGGIO” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT RANOR-
PLLAKOR, NË OBJEKTIN “GURI I ZI”, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 4 ha, që do të përdoret nga shoqëria “Fonsana Griggio” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit ranor-pllakor në objektin “Guri i Zi”, Bashkia Elbasan, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Të dhënat për sipërfaqet pyjore që zvogëlohen në volum dhe të hiqen nga fondi pyjor dhe kullor publik dhe koordinatat e poligonit të sipërfaqes, objekt mineral, janë sipas lidhjes dhe hartës topografike që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor, të produkteve të tjera pyjore dhe kullorore dhe të investimeve të kryera në vite, në sipërfaqen, objekt mineral, paguhet nga shoqëria “Fonsana Griggio” sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Elbasan, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Fonsana Griggio” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore dhe të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 1.05 ha, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Elbasan.

4. Bashkia Elbasan dhe shoqëria “Fonsana Griggio” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektin e miratuar për pyllëzimin, të dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar, sipas lidhjes bashkëlidhur, nga kategoria “Tokë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i aktivitetit mineral”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria “Fonsana Griggio” sh.p.k., të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik të Bashkisë Elbasan.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, Bashkia Elbasan dhe shoqëria “Fonsana Griggio” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Bashkia ELBASAN

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK
QË HIQEN PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHOQËRISË "FONSANA GRIGGIO" shpk

Nr.	ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/ n/ngast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha	Përdorimi territorit
1	2	3	4	5	6
1	EL70 00 59a	Zaranikë	59a	0.35	trungishte
	EL70 00 59e	Zaranikë	59e	0.63	inproduktive
	EL70 00 60b	Zaranikë	60b	1.91	inproduktive
2	EL70 00 74d	Zaranikë	74d	1.11	inproduktive
GJITHSEJ				4.00	

MINISTËR

Damian GJIKNURI




MINISTËR

Blendi KLOSI



HARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURIN E KERKUAR PER LEJE SHFRYTEZIMI SHKALLA 1 : 10 000



PER HEQJE NGA FONDI PYJOR	Nr. i pikes	KOORDINATAT	
		Y	X
OBJEKTI I RANOREVE PLLAKORE "Guri i zi" Elbasan Tabela B S = 0.04 Km ² PROJEKTOI Ekspert mjedisi H. MUÇA Sudio " Oskeola"shpk	1	44 25 321	45 64 571
	2	44 25 350	45 64 737
	3	44 25 376	45 64 738
	4	44 25 374	45 64 881
	5	44 25 392	45 64 984
	6	44 25 483	45 64 960
	7	44 25 431	45 64 555